REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

AGENCIJA ZA BESPLATNU PRAVNU POMOĆ
AGENCY FOR FREE LEGAL AID
Nr.Sh./No. 255-01 Nr.F./Arch.No. 02
Data/Datum/Date 09.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Nr. 07 /2020
Datë: 02.12.2020

Këshilli për Ndihmë Juridike Falas, në pajtim me dispozitat e nenit 13, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 02 dhjetor 2020 mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet grupi punues për hartimin e Planit Strategjik të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas si vijon:

- Beshir Islami - Kryesues i KNJF-së
- Lyra Çela – Zëvendës Kryesuese e KNJF-së
- Anita Alaj Kalanderi – U.D Drejtoreshë Ekzekutive
- Admir Salihu – Anëtar i KNJF-së
- Hidajete Vokshi - Anëtare i KNJF-së
- Flutura Berbati Zena - Udhëheqëse e Divizionit për ONJF
- Faton Jashari - Zyrtar Ligjor

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli për Ndihmë Juridike Falas në takimin e mbajtur me datë 02.12.2020, pas prezantimit të rekomandimeve nga Grupi Përgatitor lidhur me analizën paraprake dhe propozimet lidhur me zbatimin e Planit Strategjik 2015-2019 të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, ka diskutuar për nevojën e hartimit të Planit Strategjik që përcakton qartë dhe saktë objektivat dhe orientimin strategjik të punës, në të cilin do të mbështetet puna e Këshillit dhe e Agjencisë.

Grupi punues ka për obligim që në afatin sa më tështkurtër të mundshëm, mbi bazën e gjetjeve të grupit nismetar dhe diskutimeve të mbledhjës së datës 2 dhjetor 2020, të hartoi Planin

Strategjik të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, të cilën sipas përcaktimeve ligjore do ta paraqesë në Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, për miratim.

Si rrjedhojë, u vendos që të formohet grupi punues me qëllim të hartimit të planit strategjik të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, me përbërjen si në dispozitivin e këtij vendimi.

Beshir Islami,
Kryesuesi i Këshilli për Ndihmë Juridike Falas

Vendimi i dërgohet:

- *Drejtorit Ekzekutiv;*
- *Anëtarëve të Këshillit;*
- *Arkivit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas*